

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MP “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”

Ofruar nga Shkolla e Lartë Jopublike “Univesiteti Marin Barleti”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Gëzim Dibra

Prof. As. Dr. Ferdinand Canaj

Janar 2018

Për Programin e Studimit Master profesional në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”
2	Departamenti që e ofron Fakulteti	Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike
3	Urdhëri/VKM i licencimit	Urdhër i MAS Nr. 487, datë 06.10.2016
4	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”
5	Cikli i studimit:	Cikli I dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
7	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite (ECTS)
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	PO
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7 (shtatë)
15	Aktivizimi i programit të studimit	2016-2017
16	Numri total i studentëve për program studimi	117 studentë

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit MP Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte

HYRJE

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm bazohet në të dhënat e sjella nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të brendshëm, anekseve përkatëse të këtij Raporti, vizitës dy ditore të zhvilluar në Institucion më datë 9 dhe 10 nëntor 2017 si dhe dokumentacionit të marrë gjatë kësaj vizite.

Të dhëna për programin e studimit MP në “Mësuesi në Edukim fizik dhe sporte”

Programi i studimit MP në “Mësuesi në Edukim fizik dhe sporte” mbulohet nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike në Institucionin e Arsimit të Lartë SHLUJ “Universiteti “Marin Barleti””, licencuar nga MASH në vitin 2005 mbi bazën e VKM nr. 571, dt. 12.08.2005 “Për dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike Universteti “Marin Barleti”, me dy fakultete dhe pesë degë.

Aplikimi për licensimin e këtij programi studimi është bërë në MAS në vitin 2014 bazuar në ligjin Nr.9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjet Nr. 9832, datë 12.11.2007, Nr. 10 307, datë 22.7.2010, Nr. 1 0 493, datë 15.12.2011. Programi i studimit MP në “Mësuesi në Edukim fizik dhe sporte” është licencuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 487 datë 6.10.2016. në kohën kur është në fuqi ligji I ri Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, fakt ky që krijon problem për funksionimin e mëtejshëm të këtij programi dhe kërkon ristrukturimin e tij.

Ky program studimi ka filluar në vitin akademik 2016-2017, janë regjistruar 118 studentë, nga të cilët 1 student është larguar dhe përfundimisht programin e kanë frekuentuar 117 studentë. Kanë dhënë mësim 13 pedagogë. Për vitin akademik aktual , 2017-2018 janë në proces regjistrimi 120 studentë.

Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit mbulon edhe një program Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim fizik dhe sporte” i licensuar me Urdhrin nr. 505 datë 17.10.2016, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, i pakativizuar për arsye të mungesës së studentëve.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Dr Gëzim Dibra
2. Prof. As. Dr. Ferdinand Canaj

Menaxherë teknikë të ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure janë specialistët e ASCAL, Suela Kromidha dhe Emisa Isufaj.

Më datë 08.01.2018, me Nr 2 prot, Institucioni ka paraqitur pranë ASCAL përgjigje mbi Draft RVJ.

Grupi I Vlerësimit të Jashtëm pasi I lexoi me kujdes përgjigjet e SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, nuk mori në konsideratë asnjë prej pikave duke mos bërë ndryshim në RVJ. Për disa prej këtyre pikave, GVJ sqaron sa më poshtë:

Lidhur me pikën e parë: Master profesional me 60 kredite

GVJ mendon se jemi shprehur lidhur me prespektivën e këtij programi studimi. Ky Master nuk mund të vazhdojë të ofrohet me 60 kredite në fushën e mësuesi pasi është në kundërshtim me LAL 80/2015. Studentët që diplomohen me këtë total të krediteve janë jashtë standardeve ligjore për këtë cikël studimi dhe për profesionin që do të ushtrojnë pas mbarimit të studimeve. Vetë studentët në intervistën e tyre pranuan që ndjehen të rrezikuar në raport me studentët e tjera që studiojnë apo

kanë mbaruar studimet në programet e tjera Master profesional në mësuesi në këtë fushë, që ofrohen me 120 kredite, pasi institucionet që do ti pranojnë për punësim ose licensim I referohen detyrimisht kuadrin ligjor në fuqi. GVJ evidenton gjëndien dhe nuk mund të prononcohet për arsyet apo shkaqet e kësaj situate.

Lidhur me pikën dy: Mbulimi I programit në 70% me staf të brendshëm:

GVJ nuk e merr në konsideratë shpjegimin nga Institucioni, pasi mendimin e tij e ka dhënë mbështetur në fakte dhe dokumentacion të paraqitur nga vetë institucioni. Shpjegojmë që totali I krediteve bëhet duke u bazuar në ndarjen e ngarkesës së krediteve brenda lëndës (në leksion dhe seminar) e cila nuk mund të jetë e ndryshme në lëndë të ndryshme me kredit të njëjtë dhe me ngarkesë të njëjtë.

Së dyti, GVJ mendon se koinficienti I llogaritjes se ngarkesës së pedagogut në ciklin e dytë të studimeve (1 orë leksion= 2 orë të pagueshme) bëhet për trajtimin financiar të pedagogut dhe jo si ngarkesë fizike mësimore.

Për këto arsye, GVJ nuk e merr në konsideratë ndryshimin në RVJ për këtë pikë.

Lidhur me pikën e tretë” Praktikant pedagogjike

GVJ sqaron se bazuar në Udhëzimet akoma në fuqi të MASR, orët e praktikës mësimore janë orë mësimore “në auditor” dhe nuk përfshihen në ngarkesën “në mbështetje të institucionit”. Pretendimi I Institucionit se kjo praktikë është mbuluar/menaxhuar nga pedagogët Ilia Kuro dhe Gavrosh Kavaja nuk mbështetet me dokumentacionin e paraqitur nga Institucioni dhe i vënë në dispozicion gjatë vizitës në IAL (materiali ngarkesa e pedagogëve me kohë të plotë, viti akademik 2016-2017, Aneksi 8). Lidhur me pedagogen Silvana Delija, nga ky dokumentacion rezulton se mbulon vetëm 40 orë praktikë mësimore në semestrin e dytë.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

PJESA PËRSHKRIMORE

Programi i studimit të ciklit të dytë Master profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” (MP MEFS) i është nënshtruar procedurës së vlerësimit paraprak të ASCAL, kur është hapur në bazë të Urdhërit Nr.487 dt.06.10.2016 të MAS.

Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, Misioni i programit, Objektivat e tij dhe synimi në fund të realizimit të tij janë:

- përgatitja e specialistëve të sportit, njohuritë dhe aftësitë e të cilëve duhet t'i përgjigjen nivelit të zhvillimit shoqëror sportiv, në kontekst kombëtar dhe ndërkombëtar. Programi është përgatitur në përputhje me nevojat e kohës dhe për t'iu përgjigjur aspiratave për një shoqëri të zhvilluar e të integruar në strukturat evropiane duke i dhënë rëndësinë që i takon masivizimit dhe edukimit sportiv.
- Objektivat për këtë program studimi është: aftësimi studentëve si specialistë me koncepte dhe aftësi teorike e metodologjike për studimin me këndvështrimin bashkohor dhe metodat shkencore zhvillimin psikomotor tek fëmijët e grupmoshve të ndryshme etj. Ai synon përgatitjen e dyfishtë, si mësues të edukimit fizik dhe sportit por dhe si profesionistë të fushave në tërësi që lidhen me edukimin lëvizor dhe motor të tyre.
- Në fund të këtij program studimi synohet që studentët të aftësohen me kompetenca të përgjithshme, specifike dhe kompetenca të transferueshme me synimin për të studiuar probleme që lidhen me sportin

dhe të sugjerojnë zgjidhje e rekomandime në dobi të tij; aftësinë për të shkruar projekte e për të udhëhequr zbatimin e tyre; aftësinë për të marrë pjesë në debate e në diskutime publike mbi sportin.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Konfirmohet se: Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” është hartuar në përmbushje të qëllimit dhe misionit të institucionit.</p> <p>Konstatohet se: Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” plotëson misionin dhe objektivat e tij gjatë aplikimit, por bie ndesh me kërkesën e Nenit 83 pika 2 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, i cili hyri në fuqi në kohën kur ky program u licencua.</p> <p>Rezulton se: Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” orientohet nga tendencat e zhvillimit ekonomik të vendit. Ky orientim reflektohet në kurrikulën e programit të studimit si edhe në programet e lëndëve dhe moduleve.</p> <p>Rezultonse: Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” dëshmon vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit dhe përmbushin ambicien e institucionit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Rezulton se: Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” është përshtatur me strategjinë e zhvillimit institucional, veçanërisht me ambiciet e përcaktuara në strategjinë e institucionit, veçanërisht ambiciet ku flitet për Punën kërkimore; Qëndrueshmërinë dhe Profesionalizmi në Sipërmarrje, konkretisht: - <i>PUNA KËRKIMORE Të mbështetet dhe të çohet më tej puna kërkimore e një standardi më të lartë në fushat kyçe me ndikim në shoqëri dhe në ekonomi, të promovohet bashkëpunimi në punën kërkimore, të inkurajohen dhe të përkrahen kërkimet e reja në mësimdhënie dhe nxënie dhe të nxitet shpirti i kërkimit dhe komunikimit.</i></p> <p><i>QËNDRUESHMËRIA Të përsoset më tej ekspertiza në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të përfshihen aktivitete për edukimin e qëndrueshëm në kurrikulën e universitetit, duke siguruar që të diplomuarit tanë të jenë të mirë arsimuar dhe të vetëdijshëm për çështjet mjedisore, sociale dhe etike.</i></p> <p><i>PROFESIONALIZMI NË SIPËRMARRJE Të edukojë dhe të mbështesë tek të gjithë të diplomuarit shpirtin e sipërmarrjes dhe aftësinë për të shfrytëzuar</i></p>

	<p>teknologjinë e re, të nxisë perspektivat e komunitetit të biznesit dhe të ofrojë edukim dhe trajnim mbi bazën e përvojës, që i pajisin praktikantët profesionistë me dijet dhe aftësitë që iu nevojiten për të përparuar profesionalisht, t'u sjellin dobi të tjerëve dhe të krijojnë mundësi të reja..</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Rezulton se: Propozimi për Program studimi Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” në kohën e licencimit ishte në përputhje dhe konform me ligjin e Arsimit e Lartë, Nr.9741, datë 21.5.2007. Por hapja dhe fillimi i funksionimit të tij u realizua kur ka hyrë në fuqi LAL 80/2015, i cili me anë të kërkesës në Nenin 83 pika 2 bën që ky program të bierë ndesh, ose të bënte ndryshime për të plotësuar këtë kërkesë. Programi i studimit është në përputhje dhe konform me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit.</p> <p>Rezulton se: emërtimi i programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” përputhet me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Rezulton se: Institucioni ka në vëmendjen e tij ristrukturimin e këtij programi studimi, duke ndërmarrë veprimet e nevojshme për të përshtatur Programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” me kërkesat e LAL 80/2015.</p> <p>Rezulton se: Institucioni e ka planin strategjik për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të nxënit duke synuar kombinimin e nivelin teorik me atë praktik, duke shtuar motivimin për kërkim shkencor. Institucioni ka plan strategjik afatmesëm 5 vjeçar, që ka në përmbajtje drejtimet për studimet që ofron.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Programi i studimit iciklit të dytë Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” plotëson misionin dhe objektivat e tij gjatë aplikimit, është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Ligji nr.9741 “Për Arsimin e Lartë në Shqipëri” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në fuqi, si udhëzimet, në mbështetje të këtij Ligji. Ky program studimi i ciklit të dytë është përshtatur në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional. Ai ishte në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk binte ndesh me interesat kombëtare. Por në vazhdim, pas vitit 2016, ai nuk është përshtatur me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, i cili hyri në fuqi në kohën kur ky program u licencua, prandaj ky program duhet të ristrukturohet për tu përgjigjur kërkesave të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, lidhur me përgatitjen e mësuesve të edukimit fizik për Arsimin e mesëm të ulët. Kjo përbën problem për zgjidhje, pasi edhe në vitin akademik 2017-18 janë regjistruar në këtë program të ciklit të dytë të studimit, Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” 120 studentë, që kanë për të ndjekur studimet dhe diplomim në një vit akademik me 60 ECTS, kur aktualisht kërkesa e LAL,</p>	

përkatësisht Neni 83 pika 2, për këtë nivel studimi, në mësuesi, kërkon që studenti të fitojë 120 ECTS në 2 vite akademike.

2. STRUKTURA AKADEMIKE E FAKULTETIT (përgjegjës për programin e studimit)

Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, mbështetur edhe në takimet e realizuara në IAL, në strukturën e SHLUJ UMB përfshihen dy Njësi Kryesore, një Akademi, katër Institute dhe dy qendra. Ndërkohë në profilin e Institucionit në AMS nuk konfirmohen këto njësi. Fakulteti "Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike" është një nga dy Njësitë Kryesore të SHLUJ UMB. Fakulteti ka në përbërjen e tij tre departamente: Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, dhe Departamenti i Shkencave Politike.

Sipas RVB, Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme në përfundim të të cilave përfitohet diplomë sipas ciklit përkatës. Fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore - shkencore dhe nga administrata. Fakulteti ka krijuar edhe rrjetin e vet të bashkëpunimit akademik e kërkimor dhe synon ta forcojë dhe zgjerojë më tej këtë rrjet, në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, duke qenë pjesë aktive e disa projekteve që lehtësojnë bashkëpunimin në këto nivele si Institucion.

Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit është një nga 3 departamentet e këtij Fakulteti. Departamenti mbulon programet e studimit te nivelit Bachelor, Master Profesional dhe Master Shkencor. Në përbërjen e saj ka edhe dy katedra: Jean Monnet dhe Unesco Chair.

Të dhëna të përgjithshme për organizimin e SHLUJ UMB, bëhen publike dhe në ëeb faqen zyrtare, dhe manifestet e ndryshme që Universiteti publikon çdo fillim viti akademik. Baza e të dhënave si dhe e stafeve akademike dhe administratës së Institucionit, ndodhej e dokumentuar dhe na u komunikua se rifreskohet çdo fillim viti akademik nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila funksionon si hallkë ndërlidhëse midis fakulteteve, departamenteve dhe të gjitha njësive të tjera bazë që funksionojnë në SHLUJ UMB sipas Statusit dhe Rregullores së Institucionit.

VLERËSIMI I TREGUESVE TË MATSHËM:

FAKULTETI, ORGANIZIMI HIERARKIK I FAKULTETIT

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike është një nga njësitë e SHLUJ UMB që organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Fakulteti ofron programe të studimeve të ciklit të parëbachelor dhe të ciklit të dytë Master Profesional dhe Shkencor në përfundim të të cilave përfitohet diplomë sipas ciklit përkatës. Autoritetet drejtuese janë Dekani, Zëvendës Dekani, Përgjegjësit e departamenteve dhe Drejtuesi i Qendrës kërkimore. Organ drejtues është Këshilli i Fakultetit. Aparati administrativ i Fakultetit përbëhet nga Sekretaria mësimore dhe nga personeli ndihmës. Struktura organizative, përbërja, funksionimi dhe të tjera çështje që lidhen me të janë të përcaktuara në rregulloren e fakultetit.

STRUKTURA AKADEMIKE E FAKULTETIT

Fakulteti ka 3 departamente:

1. Departamenti i Drejtësisë,
2. Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit
3. Departamenti i Shkencave Politike.

Numri i stafit akademik me kohë të plotë në Departamentin i Shkencave Sociale dhe Edukimit që mbulon këtë program studimi për vitin akademik 2016-2017 ishte **12 pedagog me kohë të plotë** nga të cilët:

- 3 Prof. Dr.
- 1 Prof. Asc.
- 4 Dr.
- 4 Msc.

ndërsa, numri i stafit akademik me kohë të pjesshme ishte 43 nga të cilët:

- 3 Prof. Dr
- 4 Prof. Asc.
- 13 Dr.
- 23 Msc.

Rezulton se numri i PAK në këtë departament nga tabela nr.4 fq.26 të RVB është 43 dhe jo 45 (3 Prof;5 Prf.as; 13 Dr;25 asistente me Msc; dhe tre asistente pa Msc.) sipas numrit rendor Numri i pedagogëve të brëndëshëm ka ndryshuar gjatë vitit akademik 2017-2018 me një tendencë rritjen e numrit të pedagogeve me grada shkencore qe japin mësim në këtë program. Sipas Dekanit të Fakultetit, na u komunikua se gjatë vitit akademik 2017-2018, numri i personelit akademik me kohë të plotë është 14 pedagogë. Numri i personelit me kohë të pjesshme akoma nuk është përcaktuar pasi Institucioni ishte në procesin e rekrutimit të stafit akademik me kohë të pjesshme Pranë Departamentit funksiononte Këshilli Shkencor i programit të studimit i përbërë prej tre pedagogësh: 1 pedagog me gradën Dr, dhe 2 pedagogë me tituj Prof.Asc.Dr.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Në Aneksin 2 jepet stafi akademik PAE dhe PAK në Departamentin e Shkencave Sociale dhe Edukimit per vitin akademik 2016-2017

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>SHLUJ UMB organizohet në mënyrë që të bëjë sa më efektiv arritjen e misionit bazë të tij, mësimdhënies, dhe arritjen e objektivave bazë të paraqitura në Statut dhe Rregulloren e tij.</p> <p>Konfirmohet se: SHLUJ UMB ka në përbërjen e tij dy Njësi Kryesore (Fakultete), Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike në të cilin bën pjesë edhe Departamenti i Drejtësisë, i Shkencave Sociale dhe Edukimit dhe Fakultetin e shkencave të Aplikuara dhe Ekonomise. Ka kater institute, Instituti Shqiptar për Çështjet Publike(AIPA); Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti"(BIRD; Instituti Adriapol; Instituti i Edukimit Barleti(IEB) si dhe dy qendra Qendra e Trajnimit dhe Testimit Barleti(BTTC) dhe Qendra YouthAct.</p> <p>Konfirmohet se Fakulteti i Drejtësisë Shkencave Sociale e Politike ka në përbërje të tij këto njësi bazë: Departamenti i Drejtësisë;Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit; dhe Departamenti i Shkencave Politike</p> <p>Rezulton se: të gjitha njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, funksionojnë në bazë të rregulloreve të veçanta, të miratuara, ku përcaktohen objektivat dhe misionet e këtyre njësive.</p> <p>Rezulton se: Departamenti përgjegjës për MP MEFS, ka në përbërje të tij staf akademik që i plotëson kriteret e vendosura në LAL</p>

	<p>Stafi akademik më kohë të plotë në Departamentin e Shkencave Sociale dhe Edukimit; ka ndryshuar. Ai është shtuar me staf efektiv.</p> <p>DSHSE për vitin akademik 2016-2017 kishte 12 pedagogë me kohë të plotë dhe Staf akademik më kohë të pjesëshme janë 42 pedagogë. Ndërsa për vitin akademik 2017-2018 në rang Departamenti janë aktualisht 14 pedagogë më kohë të plotë.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitet e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitet bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitet bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Rezultoni se: njësitet bazë dhe stafi akademik që mbulon programin e studimit MP MEFS janë në dijeni për përgjegjësitë që kanë, në lidhje me realizimin e programeve që ofrojnë, konkretisht të programit të studimit “Master profesional Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” (MP MEFS). Ata përcjellin standarte në punën e tyre duke ndikuar në realizimin e misionit, objektivave dhe mbi të gjitha realizimin e një mësimdhënieje cilësore dhe bashkëkohore.</p> <p>Rezultoni se: Njësitet bazë përfshihen në rekrutimin e personelit akademik të nevojshëm, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e institucionit dhe të njësisë.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Konfirmojmë se programi i studimit Master i Profesional në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” është në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Gjithashtu konfirmohet se ka një strukturë e brendshme funksionale që punon për të përmbushur qëllimet e misionit të institucionit konform ligjit. Njësitet bazë të institucionit, qoftë administrative dhe akademike e kerkimore, bashkeveprojnë në funksion të rritjes së cilësisë, rekrutimit të stafit në plotësim të nevojave të programit. Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, ka në përbërje staf akademik në plotësim të kriterëve të vendosura nga LAL për numrin e pedagogëve në përbërje të njësive bazë, Por ky numër u gjet i ndryshuar gjatë periudhës nga viti akademik 2016-17, me shpjegimin se kërkohet kualifikimi më i lartë të stafit akademik me kohë të plotë.</p>	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

PJESA PËRSHKIMORE

Stafi akademik i institucionit është organizuar në dy struktura: Stafi në funksion të përmbushjes së programeve Bachelor, stafi në përmbushje të studimeve në nivel Master. Stafi në përmbushje të studimeve Master i Profesional në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” për vitin akademik 2016-17 përbëhej prej 7 pedagogësh PAE - 1 Prof.dr; 1 Prof. As; 3Dr; dhe 2 Msc; ndërsa pedagogë PAK që kanë dhënë mësim në këtë program kanë qënë 6 pedagogë - 2 Prof.dr; 1 Prof.asoc; 3 Dr .

Gjatë vizitës në Institucion na u komunikua numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Konfirmohet se janë 117 studentë të rregjistruar në Programin Master i Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” në vitin 2016- 2017.

Për vitin akademik 2017-2018, numri i studentëve në proces rregjistrimi është 120. Stafi në funksion të përmbushjes së studimeve në këtë Mastër është 5 PAE - 3 Prof.dr; 1 Prof.asoc; 1 Dr. Deri gjatë vizitës në Institucion, stafi PAK janë 3 me gradën Doktor i shkencave. Na u komunikua që Institucioni akoma nuk i

kishte mbyllur kontratat me personelin akademik me kohë të pjeshme i cili do të angazhohet në këtë program studimi. Shpërndarja e ngarkesës rezulton pranë normës së lejuar.

Personeli administrativ është si në shërbim të programit Master ashtu edhe të institucionit në tërësi. Zyra e Burimeve Njerëzore, ka krijuar një bazë të dhënash për personelin dhe vendet vakante të punës, dhe ndjek shpalljen e vendeve të lira, përpunimin e të dhënave. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përfshira në Statutin e IAL-së, ndërsa për stafin ndihmës që rekrutohet është bordi që miraton kriteret kryesore. Ndërkohë kriteret propozohen në varësi të vendit vakant nga strukturat përkatëse (epropri i drejtpërdrejtë).

VLERËSIMI I TREGUESVE TË MATSHËM:

Fakulteti i Drejtësisë Shkencave Sociale e Politike ka tre departamente në përbërje të tij. Numri i pedagogëve per vitin akademik 2016-17 është si me poshtë :

Departamenti i Drejtësisë : 8 PAE (1 Prof.asoc; 2 Dr,dhe 5 Msc), dhe 5 PAK (2 Prof.dr; 1 Prof.asoc; 1 Dr, dhe 1 Msc);

Departamenti i Shkencave politike: 7 PAE (2 Prof.asoc; 1 Dr, dhe 4 Msc), ndërsa 7 PAK (3 Prof.dr; 1 Prof.asoc; 1 Dr, dhe 2 Msc);

Departamenti i Shkencave sociale dhe edukimit : 10 PAE (2 Prof.dr; 1 Prof.asoc; 3 Dr, dhe 4 Msc,) 46 PAK (3 Prof.dr; 5 Prof.asoc; 13 Dr, dhe 25 Msc).

Duhet theksuar se për Departamentin e Shkencave Sociale dhe Edukimit, referuar raportit të Vlerësimit të brendshëm, numri i pedagogëve është i ndryshëm dhe varion herë 12 pedagogë PAE me 43 pedagogë PAK dhe herë del 10 pedagogë PAE me 46 pedagogë me PAK. (tabela 1 faqe 23 RVB). Gjatë takimit me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm na u komunikua që janë lapsuse gjatë hartimit të këtij raporti.

Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit

Aktualisht janë 12 pedagog efektiv - 3 Prof. (nga 2 që ishin në vitin akademik 2016-17);1 Prof.as dr;4 Dr. (nga dy që ishin në vitin 2016-17); dhe 4 Msc.).

Ndërkohë që numri i stafit akademik me kontratë është 49 (3 Prof. Dr.; 5. Profesor asoc.; 13 Dr.; 25 Msc dhe 3 asistente pa Msc.) Konstatohet se ka një raport jo të drejtë mes stafit PAE me stafin PAK.

Stafi në përmbushje të studimeve Master i Profesional "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte" për vitin akademik 2016-17 përbëhet prej 7 pedagogë PAE 1 Prof.dr; 1 prof As. 3-Dr; dhe 2 Msc), ndërsa pedagogë PAK janë 6 - 2 Prof.dr; 1 Prof.asoc; 3 Dr.). Stafi në funksion te përmbushjes së studimeve në këtë master për vitin akademik 2017-18 është PAE 5 pedagoge (3 Prof.dr; 1 Prof.asoc; 1 Dr) ndërsa stafi PAK janë deri më tani 3 me gradën Doktor i shkencave.

Vlen të theksohet fakti se:

Ky programi është vlerësuar si nga ana teknike (nga ASCAL) ashtu edhe nga ana përmbajtësore me Ekspert të fushës para se të licensohej. Mbi këtë vlerësim është bazur edhe Këshilli i Akreditimit për Vendimin e tij dhe Urdhëri i MAS mbi Vendimin e KA. Ajo që vihet re është një ndryshim i dukshëm i stafit akademik të planifikuar për mbulimin e këtij programi studimi. Duke ju referuar dokumentit të paraqitur nga Institucioni në kuadër të licensimit të tij në Maj 2016 që na u vu në dispozicion nga ASCAL, lidhur me pedagogët të cilët do të mbulonin këtë program studimi qofshin këto PAE apo PAK, rezultoi se nga 8 pedagogë të planifikuar për mbulimin e programit sipas lëndëve, në vitin akademik 2016-2017 ka dhënë mësim vetëm prof. As Gavrosh Kavaja. Kjo tregon që Stafi akademik që është paraqitur në RVB për vitin akademik 2016-17 ka shumë lëvizje (90%) nga stafi i planifikuar për realizimin e këtij programi në kuadër të licensimit të tij por edhe me stafin e planifikuar për realizimin e këtij programi për vitin 2017-18. Ky ndryshim i stafit mund të ishte i justifikueshëm nëse do të kishte si synim përmirësimin cilësor të stafit duke përfshirë në të pedagog me tituj dhe grada shkencore te një niveli më të lartë gjë e cila nuk konstatohet. Kështu pedagog titullarë që mbulojnë lëndët në listën e stafit në kohën e licensimit janë 3 prof.as. dhe 5 Dr. Ndërsa këto lëndë mbulohen në vitin akademik 2016-17 nga 2 Prof, dr ,3 Prof.asoc , 6 Dr dhe 2 Msc. Pra vihet re prania e dy pedagogëve që nuk ka gradë shkencore, dhe që është në kundërshtim si me Ligjin aktual të Arsimit të Lartë ashtu dhe me ligjin e mëparshëm.

Duke shikuar përshtatshmërinë mes lëndëve të programit të studimit me profilin shkencor dhe profesional te pedagogëve që mbulojnë këto lëndë sipas diplomimit në nivelin Bachelor apo Master, si për programin

e dorëzuar për licensim ashtu edhe në programin e studimit të vitit akademik 2016-17, rezulton se në përgjithësi ka një përputhje, me përjashtim të ndonjë rasti ku merren si të mirëqëna përvoja e pedagogut apo edhe eksperiencia e tyre, por që nuk kanë ndonjë rëndësi në aspektin total të programit.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit
Ka këshill shkencor me 3 antarë me tituj dhe grada shkencore, drejtues i Masterit është Migena Kapllani
 - Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre
Rezulton se stafi që jep mësim në programin Master si ai efektiv dhe ai me kontratë është me tituj dhe grada shkencore. Por duhet të pranojmë se ka edhe dy pedagogë me Mastër shkencor që japin mësim në kundërshtim me ligjin i cili thotë se në nivelin Mastër duhet të aktivizohen vetëm pedagogë me tituj dhe grada shkencore.
 - Të dhënat sipas seksit
Rezulton se nga i gjithë stafi akademik (PAE & PAK) **raporti sipas seksit në programin e studimit është 7 femra dhe 6 meshkuj**, ndërsa në shkallë departamenti stafi (PAE&PAK) është **38 femra dhe 28 meshkuj.**
 - Të dhëna sipas moshës së personelit
Në përgjithësi stafi akademik efektiv (PAE) ka një moshë të re dhe i ndarë sipas grupimit 25-45 vjeç janë 14 vetë staf akademik dhe sipas grupimit 45-65 janë vetëm 9 vetë staf akademik, dhe sipas grupimit 65-68 stafi akademik janë 4 Ndërsa stafi akademik me kontratë (PAK) grupimi 25-45 janë 16 vetë dhe grupimi 45-65 janë 20 vetë dhe sipas grupimit 65-68 stafi akademik janë 7.
- Të dhënat janë për të gjithë stafin e departamentit për vitin 2016-2017.**
- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat
Konfirmojmë se të gjithë antarët e stafit akademik dhe administrativ janë më kontratë të rregullt pune me afat të caktuar ose pa afat.
 - Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë
Stafi ndihmës, **rezulton se është i përgatitur dhe punon me seriozitet.**
 - Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
Lista e pedagogeve të departamentit dhe të stafit të angazhuar për programin e studimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Konfirmohet se: personeli akademik dhe administrativ i institucionit angazhohet seriozisht në përmbushje të qëllimeve të programit dhe të strategjisë së institucionit.
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Rezulton se: Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ përfshihet në mbështetje të të gjitha programeve të studimit.
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Konstatohet se: Personeli akademik qoftë PAE dhe PAK, angazhohet sistematikisht në hartimin e kurrikulës, dhe ndjek rrugën institucionale për miratimin e saj. Për MP MEFS nga fillimi i tij në vitin akademik 2016-2017 dhe vitin e ri akademik 2017-2018 personeli akademik është ndryshuar në më tepër se 80 %.</p> <p>Rezulton se: Rekrutimi i personelit akademik dhe ndihmës bëhet konform ligjeve që rregullojnë raportet kontraktuale të stafit me institucionin dhe ngarkesa mësimore rezulton të jetë e mirërregulluar. Rekrutimi bëhet në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës për njoftimit, procedurën e rekrutimit, lidhjen e kontratës e termat e saj etj. Rregulla mbi mënyrën e përcaktimit të nevojave për punësim, autoriteteve që përcaktojnë kriteret , ngritjen e komisioneve ad-hoc.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Konstatohet se: Institucioni ndjek procedura ligjore transparente për rekrutim të stafit PAE dhe PAK dhe në institucion gjenden të gjitha kontratat e nënshkuara me anëtarët e stafit akademik në mënyrë të përditësuar.</p> <p>Konfirmojmë se: nuk del e qartë nëse personeli akademik efektiv në Departamentin e Shkencave sociale dhe edukimit që mbulon programin e studimit Master profesional Mësuesi në Edukim fizik dhe sporte përbën 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e këtij programi. Mbulimi i ngarkesës së programit është bërë mbi bazë kreditesh dhe jo ngarkesë orësh të pedagogëve. Nga ana tjetër nuk është marrë në konsideratë se ky master ka 3 grupe dhe ngarkesa në seminare nuk është 20 orë por 60 orë. Ngarkesa e planifikuar për orët e praktikës dhe të mbrojtjes së diplomës 75+125 orë nuk pasqyrohet në ngarkesat e pedagogeve (vetëm një pedagoge thuhet se mbulon 45 orë praktikë).</p> <p>Nga të dhënat e dorëzuara në Raportin e Vlerësimit të brendshëm por edhe të dhënat e marra në Institucion, konfirmojmë se Ngarkesa e stafit akademik me kohë të plotë në vitin akademik 2016-2017 rezulton të jetë 63%</p> <p>Konfirmohet se: institucioni reflekton seriozitet, vijshmëri të dokumentuar vlerësimin periodik të personelit.</p> <p>Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e UMB ka një bazë të dhënash (dosje personale aplikimi dhe punësimi, tabela statistikore) për të gjithë personelin</p>

	Ngarkesa totale e stafit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme për vitin akademik 2016-2017 dhe 2017-2018 është paraqitur në Aneksin 8 të këtij raporti
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master Profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Konstatohet se: Përgjegjësi i Programit gëzon gradën shkencore Dr. fituar në Universitetin e Tiranës.</p> <p>Konfirmohet se: Çdo titullar i lëndës në programin në fjalë gëzon minimalisht titullin Dr. dhe përvojë punë më shumë se 5 vjet.</p> <p>Rezulton se: Në rastet kur lënda zhvillohet nga pedagog me Master shkencor si në rastin e lëndës Metodike e sporteve individuale, Programi lëndor (syllabusi) është hartuar nga një pedagog me titull shkencor që mban përgjegjësi për këtë lëndë.</p> <p>Konfirmohet se: Rektori, zv/rektori, dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve në fjalë.</p> <p>Konfirmohet se: Ndonëse është theksuar se praktika profesionale mbulohet nga udhëheqës dhe mbikëqyrës nuk ka nje shperndarje te ngarkesës së pedagogëve për këtë aspekt.</p>
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e</p>	<p>Konfirmohet se: Në programin e studimit në fjalë ndjekin studimet 117 studentë. Institucioni ka siguruar që për çdo student të ketë një udhëheqës në punën kërkimore për përgatitjen e tezës deri në përfundim të ciklit të studimit (vetëm studentët me mesatare mbi 9,5). Si edhe konfirmohet edhe nga studentët kontakti me pedagogun është më shumë nepërmjet E-Mail-it. Këtë fakt e konfirmon edhe mungesa e ngarkesës së pedagogëve apo edhe mosprania e ketyre orëve në orarin mësimor.</p> <p>Konfirmohet se: nuk na është paraqitur ndonjë listë e studentëve dhe e udhëheqësve të tyre</p>

<p>shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Rezulton se: ka një paketë të mbrojtjes finale dhe nga komiteti shkencor caktohen udhëheqësit shkencor për cdo teme të studentëve. Nuk na është paraqitur ndonjë listë e studentëve dhe e udhëheqësve të tyre</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Rezulton se: Udhëheqësit e studentëve përgjatë tezës, gëzojnë ekspertizë adequate në raport me temën e zgjellur nga studenti. Kjo konstatohet nga biseda me pedagogë që janë udhëheqës së temave të studentëve si dhe nga biseda me studentë.</p> <p>Konfirmohet se: Pedagogët që udhëheqin temat e diplomës janë të profilit përkatës dhe zotërojnë mjaftueshëm formimin teorik dhe eksperiencat për të çuar studentet deri në përmbyllje të tezave të studimit.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Rezulton se: Institucioni angazhohet dhe vë në dispozicion laboratorët dhe infrastrukturën teknologjike për përgatitjen e tezave dhe të detyrave përgjatë arritjes së qëllimeve dhe objektivave të programit.</p> <p>Rezulton se: Institucioni ka personel ndihmës për pajisjet e teknologjisë mësimore dhe mirëmban pajisjet kompjuterike në laboratorin e informatikës dhe atë të fizioterapisë. Nga 5 laboratorë që përmenden në RVB, Grupi i Vlerësimit të jashtëm vizitoi vetëm lab. informatike në 2 ambiente dhe një lab. fizioterapie.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Konfirmohet se: Ngarkesa mësimore është e detajuar në orë mësimore për cdo pjesëtar të stafit PAE dhe PAK, kjo konform akteve në fuqi dhe është e rregulluar dhe sanksionuar në kontratën individuale të secilit.</p> <p>Konfirmojmë se ngarkesa e pedagogëve është llogaritur në orë mësimore 60 minutëshe sipas udhëzimeve dhe Ligjit të ri të Arsimit të lartë.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Konfirmohet se: Egziston një bazë të dhënash të detajuara për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit. Në zyrën e burimeve njerëzore ka një informacion të plotë të këtij stafi.</p> <p>Konfirmojmë se IAL disponon listën e plotë të personelit akademik që jep mësim në Programin Master profesional “Mësuesi në edukim fizik dhe sporte”. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Sekretaria Mësimore kanë informacion të plotë për personelin e angazhuar në realizimin e programit dhe periudhën kohore të realizimit të detyrave përkatëse.</p> <p>Konfirmojmë se: Institucioni publikon kriteret për procedurat e rekrutimit të stafit dhe ndjek ato me korrektesë.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:
Autoritetet drejtuese si: Rektori, zv/rektori, dekan, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve në fjalë. Personeli akademik qoftë PAE dhe PAK, angazhohet sistematikisht në hartimin e kurrikulës së programit në fjalë, dhe ka ndjekur rrugën institucionale për miratimin e saj. Personeli akademik në kohën e licensimit pra në fillimet e MP MEFS krahasuar me personelin akademik 2016-2017 është ndryshuar në më tepër se 90%. Por edhe personeli akademik për vitin e ri akademik 2017-2018 ka ndryshime. Kjo flet për paqëndryshmëri të stafit lidhur me këtë program studimi. **Duhet të theksohet se mbulimi 70% i programit nga stafi i brendshëm, i deklaruar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, nuk del e qartë tërësisht pasi llogaritja bëhet me kredite dhe jo me orë mësimore, dhe se nuk ka një shpërndarje ngarkese për orët e praktikës profesionale dhe tezës së diplomës. Referuar krediteve, sërisht llogaritja nuk është e saktë pasi kreditet nuk ndahen njëjloj përkundrejt orëve të leksioneve dhe orëve të seminareve.**
Institucioni publikon kriteret për procedurat e rekrutimit të stafit dhe ndjek ato me korrektesë. Udhëheqësit e studentëve përgjatë tezës, gëzojnë ekspertizë adequate në raport me temat e zgjedhura. Institucioni angazhohet dhe vë në dispozicion laboratorët dhe infrastrukturën teknologjike për përgatitjen e tezave dhe të detyrave përgjatë arritjes së qëllimeve dhe objektivave të programit. Mendojmë se raporti mes stafit PAE me stafin PAK duhet të ndryshojë, duke shikuar me përparësi rekrutimin e stafit të ri të domosdoshëm dhe të qëndrueshëm

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

PJESA PËRSHKIMORE

Terma reference:

Në raportin e vlerësimit të brendshëm theksohet se Institucioni ndjek një politikë zgjerimi duke shtuar investimet në ambiente. Janë ndërtuar salla leksionesh me kapacitet të mjaftueshëm, për studentët e regjistruar, kampusin e ri në Selitë që i shërben programeve Bachelor dhe Master të Edukimit Fizik. Na u komunikua se:

- Ambientet përdoren ditët e javës për seminare në kampusin e ri në Selitë dhe leksionet ditën e shtunë në godinën qendrore në kampusin primar.
- Sallat e leksioneve plotësojnë kushtet për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve.

- Praktika mësimore zhvillohet nëpër shkolla të sistemit parauniversitar në Tiranë dhe nga ku kanë origjinë studentët.

- Biblioteka e institucionit është e ndarë në dy ambiente nga të cilat ajo që ndodhet në kampusin e ri është e pajisur me tekste mësimore të kataloguar dhe jo (si bibliotekë e re), por për këtë program titujt janë të pakët. Leksionet dhe literatura u dërgohet studentëve me e-mail ose fotokopje. Biblioteka, që shërbent edhe si sallë interneti, ka një orar shërbimi si edhe mundësi për të regjistruar anëtarët dhe librat që mund të përdorin, kjo edhe kur ata e përdorin literaturën duke tejkaluar afatet.

VLERËSIMI I TREGUESVE TË MATSHËM:

Ambienti sallë leksionesh ka kapacitet prej 120 vendesh me pajisjet për videoprojeksion si edhe 4 Aparate Ajër të Kondicionuar. 2 ambientet Laborator Informatike kishin 20 poste me 18-set PC funksional, pa videoprojektor. Ambienti laborator fizioterapie kishte 2 postera të sistemeve, një shtrat me një manekin, si edhe 2 ndenjese për studentët, pa videoprojektor. Edhe pse i kërkuam të verifikonim labororet, përgjigja ishte se në këtë program nuk ka të planifikuar mësim në laboratore. Praktikantët bëhen në ambjentet private të pedagogëve në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara me ta. Laboratorët që vizitua ishin 1 për lëndët nga 5 që shkruhet në RVB fq. 32 dhe 2 informatike nga 7 që shkruhet në RVB. Për laboratorët e tjerë që nuk i pamë, na u tha se përdorin tek privatet me kontratë por nuk na u tregua asnjë kontratë bashkëpunimi e tillë.

Mjediset për Programin e studimit të vëna në dispozicion për këtë program janë si më poshtë. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të këtij programi studimi këto mjedise:

Në kampusin 2

- 1 (një) sallë për leksione me 120 vende kapacitet.
- 3 (tre) klasa për seminare sipas grupeve.
- 1 (një) sallë për statistikë dhe kërkim shkencor që zhvillohet në laboratorin e informatikës.
- 1 (një) sallë interneti ose për shërbim bibliotekë.
- Ambientet e sekretarisë për fotokopjime literature. Në këtë ambjent informohen studentët për provimet, ecurinë e tyre dhe informacione të tjera.
- Tualete për meshkuj dhe femra
- 1 (një) ambient bar - kafe.

Mjediset për stafin:

Institucioni ka vënë në dispozicion të këtij programi studimi:

- Zyrë për Dekanin,
- Zyrë për Kancelarin,
- 2 (dy) zyra për Sekretarinë mësimore,
- 1 (një) zyrë për Departamentin,
- 1 (një) zyrë për Qendrën kërkimore,
- 2 (dy) zyra për personelin akademik
- 1 (një) zyrë për pedagogët e jashtëm.

Të gjitha këto ambiente u vizituan nga GVJ gjatë vizitës në IAL.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Konfirmojmë se: Institucioni ka dy kampuse në pronësi të aksionarëve të tij. Për programin MP MEFS ka salla leksionesh me kapacitet të mjaftueshëm për studentët e regjistruar.</p> <p>Konfirmojmë se: Institucioni ka mjedise të cilat janë në shërbim të zhvillimit të procesit mësimor të MP MEFS. Këto ambiente që kanë qenë në fillimet e institucionit, janë shtuar vitet e fundit në kampusin e ri në Selitë.</p> <p>Konfirmojmë se: Institucioni ka mjedise të cilat janë në shërbim të zhvillimit të procesit mësimor për programin e studimit MP MEFS. Ambientet përdoren ditët e javës për seminare në kampusin e ri në Selitë dhe leksionet ditën e shtunë në godinën qendrore në kampusin primar.</p> <p>Konfirmojmë se: Institucioni ka mjedise të cilat plotësojnë kushtet për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve.</p> <p>Praktika mësimore zhvillohet nëpër shkolla të sistemit parauniversitar.</p>
---	---

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Konfirmojmë se: Institucioni ka bibliotekë të pajisur me libra me tituj të teksteve mësimore të kataloguar dhe jo (si bibliotekë e re), por për këtë program titujt janë të pakët.</p> <p>Konfirmojmë se: Në bibliotekën e kampusit në Selitë, ka mungesë të literaturës specifike për të mbështetur punën e studentit në fushën e edukimit fizik.</p> <p>Konfirmojmë se: në bibliotekën e kampusit në Selitë, ka botime periodike për të mbështetur punën e studentit në fushën e edukimit fizik.</p> <p>Rezulton se: pedagogët u dërgojnë me e-mail ose me printime (që fotokopjohen në sekretari) leksionet dhe literaturën për kërkim.</p> <p>Rezulton se: Biblioteka ka orar shërbimi, si edhe ofron mundësi për të regjistruar anëtarët dhe librat që mund të përdorin, kjo edhe kur ata e përdorin literaturën duke tejkaluar afatet.</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Rezultoni se: Institucioni edhe pse dëshmon në RVB se kas 5 (pesë) laboratorë, GVJ evidentoi një laborator fizioterapie dhe 2 (dy) laboratorë informatike. Për laboratorët e tjerë na u tha se i përdorin tek privatët me kontratë por nuk na u tregua asnjë e tillë.</p> <p>Konfirmojmë se: ambienti sallë leksionesh ka kapacitet prej 120 vendesh me pajisjet për videoprojeksion si edhe 4 (katër) Aparate Ajër të Kondicionuar.</p> <p>Konfirmojmë se: 2 (dy) ambientet Laborator Informatike kishin 20 poste me 20-set PC funksional, pa videoprojektor.</p> <p>Ambienti laborator fizioterapie kishte 2 (dy) postera të sistemeve, një shtrat me një manekin, si edhe 20 ndenjese për studentët, pa videoprojektor.</p> <p>Rezultoni se: edhe pse i kërkuam të verifikonim laboratoret, na u tha se në këtë program nuk ka të planifikuar mësim në laboratore.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Infrastruktura e vënë në dispozicion të Programit të studimit MP “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte” përfshin ambiente për Leksione dhe Seminare që i plotësojnë kriteret, ndërsa për laboratore nuk janë planifikuar përveç atyre të statistikës dhe kërkimit shkencor, që e konfirmuam edhe prej studentëve, se zhvillohen në laboratorin e informatikës.</p> <p>Stafi akademik si edhe ai administrativ është i sistemuar në zyra në të cilat janë instaluar pajisjet e nevojshme për një funksionim normal.</p> <p>Ekziston biblioteka si ambient, por ajo funksionon kryesisht si sallë interneti, pasi titujt në të janë të pakët lidhur me interesin e këtij programi studimi.</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

PJESA PËRSHKRIMORE

Përsa i takon pjesës financiare, na u komunikua se IAL SHLUJ UMBështë shoqëri tregëtare, që përfiton të ardhura nga shërbimet që ofron në fushën e Arsimit të lartë. Të ardhurat sigurohen kryesisht nga tarifat e studimit që paguajnë studentët. Institucioni ka një personel të veçantë për shërbimet financiare, të cilët janë Kancelari, Administratori, përgjegjësi i financave, financieri, veprimtaria e të cilëve përmbush detyrat financiare, si edhe i nënshtrohet auditiveve të ndryshme.

VLERËSIMI I TREGUESVE TË MATSHËM:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi, referuar RVB por edhe takimeve në vend, paraqiten si më poshtë për vitin 2016:

- | | |
|--|------------------|
| • Konsulencat, shërbimet | 9.943.761 lekë |
| • Tarifat për dhe gjatë shkollimit | 12.2819.073 lekë |
| • Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) | 4.480.183 lekë |
| • Të tjera (qera, ndryshime kursi valutor, interesa bankare) | 927.427 lekë |

Kostoja për student për vitin e fundit akademik është 1150 euro

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Konfirmohet se: institucioni ka nje raport financiar ku pasyrohen të dhënat financiare, kostot, dhe zërat e tjerë të buxhetit që lidhen me realizimin e programit te studimit në fjalë.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Konfirmohet se: auditi i brendshëm posedon një tabelë të saktë lidhur me grandet dhe të ardhurat e tjera të përfituara në funksion të realizimit të programeve të studimit si edhe eficiensën e përdorimit për kontrata e shërbimeve të nevojshme për realizimin e këtyre programeve.
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Konfirmohet se: auditi i brendshëm bën analizë për përdorimin e të ardhurave prej tarifave të paguara nga studentët.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.	Konfirmohet se: institucioni harton një raport që pasyron të dhënat financiare si edhe kostot për realizimin e programeve.
Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	Konfirmohet se: institucioni tregon se ka qëndrueshmëri financiare
Konkluzionet e vlerësimit: IAL SHLUJ UMB është shoqëri tregëtare, që përfiton të ardhura nga shërbimet që ofron në fushën e Arsimit të lartë. Të ardhurat sigurohen kryesisht nga tarifat e studimit që paguajnë studentët. institucioni ka një personel të veçantë për shërbimet financiare, të cilët janë Kancelari, Administratori, përgjegjësi i financave, financieri, veprimtaria e të cilëve përmbush detyrat financiare, si edhe i nënshtrohet auditiveve të ndryshme. Institucioni harton një raport që pasyron të dhënat financiare, kostot, dhe zërat e tjerë financiarë. Auditi i brendshëm posedon tabela të sakta lidhur me grandet dhe të ardhurat e tjera të përfituara në funksion të realizimit të programeve të studimit si edhe eficiensën e përdorimit për kontrata e shërbimeve të nevojshme për realizimin e këtyre programeve. Auditi i brendshëm bën analizë për përdorimin e të ardhurave prej tarifave të paguara nga studentët. Institucioni harton një raport që pasyron të dhënat financiare si edhe kostot për realizimin e programeve. Institucioni tregon se ka qëndrueshmëri financiare.	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

PJESA PËRSHKRIMORE

IAL Marin Barleti ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre. Dokumenti i Politikës së Vlerësimit përmban kritere të sigurimit të cilësisë, funksionet e organizmave të sigurimit të cilësisë dhe procedura të vlerësimit të brendshëm. Sigurimi i Cilësisë në UMB realizohet nëpërmjet Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë që parashikohet nga neni 16 i Rregullores Akadematike të programit të studimit Master Profesional, si një organ i pavarur, i cili ka akses në të gjitha informacione të Universitetit. ZSBC është e përbërë nga një grup pune prej dy individësh të përkatësish: Dr. Migena Kapllani përgjegjëse e njësisë dhe përgjigjet për sigurimin e cilësisë në nivelin Master si dhe Esmeralda Hasani Msc, përgjigjet për sigurimin e cilësisë në nivelin Bachelor. Kjo zyrë harton politika të vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese, dhe pas plotësimit të tyre prej studentëve apo pedagogëve, ZSBC bën përpunimin e dhënave dhe nxjerr problematikat kryesore.

VLERËSIMI I TREGUESVE TË MATSHËM:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët.
- Me studentët bëhen dy vlerësime në vit sipas Lëndëve që ka programi për çdo semestër.
- Sa studentë janë anketuar
 - Në rastin e Master Profesional Mësuesi në Edukim fizik dhe sporte rezultojnë të jenë anketuar studentët që kanë qënë prezent nga kursi. Duhet theksuar se në anketim janë përfshirë lëndët që janë bërë sipas planit mësimor në dy semestra.
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - ka probleme specifike të identifikuar nga studentët
 - Kontrolli i brendshëm i cilësisë
 - funksionon dhe një mirë rolet e NJSBC
 - Politikën e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
 - Bazuar në probleme specifike të identifikuar nga studentët, janë bërë ndryshime në kurrikula, në shërbime të studentëve, apo edhe mbyllje kontrate (në takim me stafin akademik në u tregua një rast i largimit të një pedagogu. pikerisht nga pyetsorët me studentët)
 - Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Një fotokopje të një model pyetsori me rezultate.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	

Kriteri 1

Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;

Kriteri 2

Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;

Kriteri 3

Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;

Kriteri 4

Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.

Të tërthorta:

- a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;
- b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;
- c. Pyetje konceptuale;
- d. Intervista;
- e. Etj.

Të drejtpërdrejta:

- a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.);
- b. Dëgjime në auditor;
- c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;
- d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;
- e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;
- h. Etj.

Konstatohet që: sigurimi i brëndshëm i cilësisë format dhe instrumentet e vlerësimit inicohen nga Komisioni i sigurimit të cilësisë dhe Njësisë të sigurimit të brëndshëm të cilësisë, si institucione të pavarura ku përpunohen informacioni dhe merret feedback-u prej studentëve. Kjo Njësi insiston në vlerësimin e dy anshëm, nga vetë stafi dhe nga studentët njëkohësisht. Stafi është i detyruar të vetëvlerësojë punën çdo tre muaj.

Konstatohet që: Institucioni aplikon metodologji vlerësimi të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për të bërë vlerësimin. Metodatat më të aplikuara janë sondazhe të studentëve dhe pyetje konceptuale.

Konfirmohet se: Zyra e sigurimit të cilësisë merr në konsideratë për vlerësimin e cilësisë së programit, rezultatet e studentëve, testimet, provimet, punët e pavaruara, pjesëmarrjen në auditor, mardhëniet e studentit me biblioteken dhe literaturën, etj.

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Konstatohet që: rezultatet e vlerësimit të brendshëm prezantohen dhe analizohen në Senatën Akademik të institucionit por nuk kemi asnjë botim, broshurë, të hartuar enkas nga Institucioni për këtë qëllim në këtë program.</p> <p>Rezultoni se: se ka një rubrikë për sigurimin e cilësisë në faqen zyrtare të institucionit ku deklarohet funksionimi i Komisionit të sigurimit të cilësisë dhe i NjSBC, por nuk ka ndonjë rubrikë në faqen e internetit të institucionit për vlerësimin e brendshëm të këtij programi studimi.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Konstatohet që: Institucioni zhvillon analizë vjetore për ecurinë e programeve të studimit, por nuk dëshmojmë se duke ju referuar vlerësimeve që kanë dalë, të ketë pasur përmirësim apo ndryshim të programit në fjalë, (Master Profesional Mësuesi në Edukim fizik dhe sporte) në emër të përmirësimit të cilësisë. Ndryshimet konstatohen vetëm në nivel stafi akademik.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>	<p>Konstatohet që: IALU MB është akredituar për herë të parë në nivel institucioni me Urdhërin nr.288 datë 04.09.2009 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit. Me vendimin e Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin lartë (ASCAL) numër 9 datë 7.04.2017. jepet IALUM B akreditim institucional për një periudhë 6 vjeçare deri në datë 6.04.2023.</p> <p>Konstatohet që: Institucioni përdor instrumenta të ndryshëm për sigurimin e cilësisë si formularë, pyetsorë, raporte të njësisë.</p> <p>Rezultoni se: Institucioni dhe Departamenti ndjek procedura periodike për sigurimin e standardeve dhe cilësisë, relativisht përdor mekanizma formalë, për të bërë mbikëqyrjen e vazhduar të programit, por edhe si konstatohet gjatë takimeve me stafin nuk ka asnjë ndryshim të programit në fjalë.</p> <p>Konstatohet që: institucioni njih rëndësinë vlerën dhe dobinë e programit në fjalë.</p>

Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	
Konkluzionet e vlerësimit:	
Institucioni përdor në mënyrë periodike forma vlerësimi që lidhen me ecurinë e programit. Format dhe instrumentet e vlerësimit inicohen nga Zyra e sigurimit të cilësise, përpunohen dhe marrin feedback prej studentëve. Kjo Zyre insiston në vlerësimin e dy anshëm, nga vetë stafi dhe nga Studentët njëkohësisht. Stafi është i detyruar të vetëvlerësojë punën çdo tre muaj. Zyra e sigurimit të cilësise merr në konsideratë, rezultatet e studentëve, testimet, provimet, punët e pavaruara, pjesëmarrjen në auditor, mardhëniet e studentit me bibliotekën dhe literaturën, etj. Nuk ka rezultatet e vlerësimit të botuara në trajtë broshure. Ka analizë vjetore për vlerësimin por nuk ka feedback, {nuk ka ri-formatim të programit që nga viti 2013.	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

PJESA PËRSHKRIMORE

Programi mësimor i ciklit të dytë MP MEFS organizohet në një vit akademik me 60 ECTS dhe në përfundim studentët e fitojnë diplomën me provë finale ose mbrojtje (vetëm studentët me mesatare mbi 9,5). Studimet sipas orarit zgjatin 37 javë mësimore, ndërsa praktika profesionale zhvillohet gjatë 15 javëve të semestrit të dytë në shkollën të sistemit parauniversitar. Studentët shprehen se zgjedhja e këtyre shkollave është bërë sipas mundësive të tyre, edhe në qytete të tjera. Mësimi zhvillohet tre ditë në javë, ditët e Enjte, të Premte nga ora 16.00 - 20.00 dhe të Shtunën nga ora 08.30-14.30. Nga takimi që patëm me Studentët, konstatuam dhe na u bë e ditur se Studentët ndihen se kreditet që marrin në këtë program mund të penalizojnë në procesin e punësimit duke u krahasuar me diplomat 120 ECTS që lëshojnë IAL e tjera.

VLERËSIMI I TREGUESVE TË MATSHËM:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi
- Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)
 - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
 - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
 - 1 ECTS ka 10 orë mësimore në auditor
 - 1 orë mësimore zgjat 60 minuta

Në takimin me GVB na u komunikua se semestri i parë në auditor ka zgjatur 15 javë për semestrin e parë dhe 15 javë për semestrin e dytë. Praktika mësimore është realizuar në 125 orë në tre muaj, ku studentët kanë ndjekur 5 (pesë) orë në ditë. 14 orë në javë janë mësim

Nuk ka ndryshime në Planin mësimor, krahasuar me programet mësimore të licencuara (Aneksi 6). Gjatë kontrollit të planeve mësimore verifikuar edhe sipas Orarit mësimor konfirmohet se nuk ka patur zbatueshmëri të programit të licencuar, pasi u gjet se lënda Planikimi i mësimdhënies dhe i të nxënësimit me 5 ECTS me 50 Ore gjithsej në Auditor nga të cilat 30 leksione dhe 20 seminare, e programuar në të jepet në semestrin e parë pasi i paraprin praktikës pedagogjike, u gjet se është zhvilluar në javët 31 deri 37 mësimore dhe semestri i dytë të jetë zgjatur 7 javë kështu edhe viti akademik ka zgjatur 37 javë nga 30 të planifikuara.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 30 orë në auditor
- Për Seminaret 20 orë në auditor
- Për Praktikën Profesionale 75 orë në auditor dhe 50 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 125 orë në auditor dhe 250 orë punë e pavarur e studentit

Totali i orëve në auditor për leksionet është 240 orë; ndërsa totali i orëve në auditor për seminaret është 160 orë, në një vit akademik.

Për çdo lëndë, totali i orëve jashtë auditorit është 75 orë

Totali në auditor është: 240 orë (leksione) + 160 orë (seminare) + 75 orë (praktika) + 125 orë Provimi përfundimtar = 600 orë mësimore

Të gjitha lëndët janë planifikuar me ngarkesën në kredite 5 (pesë)

Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës është paraqitur në fund të raportit (Aneksi 7)

U verifikuan se Syllabus-et paraqiteshim me elementët përbërës të tyre si më poshtë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Konfirmohet se: Institucioni me daljen e urdhërit nr.486 dt. 6.10.2016 për hapjen e këtij programi studimi, fillon veprimtarinë akademike. Programi I studimit është i organizuar në lëndë mësimore, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Konfirmohet se: në programin e studimit dhe planin mësimor studenti përfiton 60 ECTS brenda 2 semestrave në 30 javë mësimore. Por në realitet, programi i studimit ka zgjatur 37 javë.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;	Konfirmohet se: Programi i studimit MP MEFS përshtatet me strategjinë e institucionit për zhvillim. Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS ngrihet mbi bazën e Programit Bachelor të studimit në Edukim Fizik dhe Sporte me synim përgatitjen më të thelluar në fushën e edukimit.
Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;	Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS mundëson pajisje të studentëve me kompetenca të përgjithshme profesionale në këtë fushë, pasqyruara këto në komponentët e e planit mësimor.
Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe	Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS u jep studentëve një kualifikim të përgjithshëm profesional duke

<p>profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>synuar nje formim te domosdoshme per kualifikimin si mesues i edukimit fizik dhe sportit.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Konfirmohet se: Përmbajtja dhe objektivat e programit të studimit janë në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen.</p> <p>Konstatohet se: vlerësimi i studentit kryhet në përputhje me rregulloren e studimeve: ku përfshuhet vlerësim i vazhduar (detyrë kursi, studim rasti, projekt, analizë dokumenti, etj.) dhe provimi përfundimtar (me gojë ose me shkrim)..</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disaveçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS është mbështetur në punën e mirë të IAL-ve të tjera të vendit dhe të huaja, të kësaj fushe.</p> <p>Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS është mbështetur në standarde të IAL-ve të tjera të vendit dhe të huaja, të kësaj fushe, duke mundur formatin e transferimit të krediteve të fituara.</p> <p>Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS është mbështetur në standarde ligjore të tjera të vendit dhe të rregulloreve të huaja të kësaj fushe, duke mundur studentëve hyrjen në provim shteti.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p>Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS ka synim pajisje e studentëve me njohuri profesionale dhe të kërkimit në fushën e Edukimit Fizik.</p> <p>Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS përfuthet me strategjitë e zhvillimit institucional.</p>

<p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS ka angazhimin e plotë të personalit akademik për arritjen e realizimit të programit.</p> <p>Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS ka përputhje të plotë me synimet e programit</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS i ofruar me 60 Kredite, nuk mund të jetë në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS ka përputhje të plotë me nevojat e sektorit përkatës vendas dhe të huaj.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS ka përputhje të plotë me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar..</p> <p>Konstatohet se: Programi i studimit MP MEFS ka studim tregu në përputhje me synimet për punësimin e studentëve .</p> <ul style="list-style-type: none"> Disa nga studentët janë të punësuar në arsim. Numri i kërkuar fillimisht për kuota ishte 25, por pas Raportit të vlerësimit nga MAS të kapaciteteve infrastrukturore numri i studentëve të regjistruar për vitin akademik 2016-2017 ishte 118. Nje nga këta studentë është larguar dhe aktualisht programin e studimit e kanë ndjekur 117 studentë nga të cilët njëi pa matrikull. Ndërsa për vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 120 studentë të cilët do të ndjekin programin 1 vjeçar me 60 ECTS.
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Konstatohet se: Programi master nuk bie ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Konstatohet se: ky programi i studimeve synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>

Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Programi realizohet me 60 kredite dhe me kohëzgjatje 1 vit akademik.
--	---

Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Konfirmohet se: studentëve u jepet rregullorja e studimeve, plani mësimor, programet e lëndëve, orari i mësimit, ndërsa paketa e praktikës dhe e provës finale jepen në periudhën para fillimit të tyre.
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Konfirmohet se: programet e studimit i ofrohen studentëve në formë të shkruar dhe elektronike. Programi I studimit është i publikuar në faqen zyrtare të internetit. Kjo është ndihmesë për studentët që kanë interes të regjistrohen në program studimi pasi njihen paraprakisht me lëndët që ofron programi.

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Konfirmohet se: Rregullorja e Studimeve përcakton kushtet dhe procedurën e diplomimit. Dokumenti i Provës Finale parashikon mënyrën e realizimit të diplomimit me 15 ECTS, provim përfundimtar ose temë diplome vetëm për studentet me mesatare mbi 9.5.
Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit MP MEFS përshtatet me strategjinë e institucionit për zhvillim dhe ngrihet mbi bazën e Programit Bachelor të studimit në Edukim Fizik dhe Sporte me synim përgatitjen më të thelluar në fushën e edukimit.

Programi i studimit MP MEFS është mbështetur në punën e mirë të ial ve të tjera të vendit dhe të huaja, të kësaj fushë.

Ky program mbështetet në standardet ligjore të vendit dhe të rregulloreve të kësaj fushe me synim pajisjen e studentëve me njohuri profesionale dhe të kërkimit në fushën e EF.

Programi i studimit MP MEFS përputhet me strategji të zhvillimit institucional dhe me synimet për punësimin e studentëve, si edhe me synimet e programit, me nevojat e tregut të punës sipas studimit të tregut.

Kuotat e kërkuara në fillim ishin 25, dhe të regjistruar për vitin akademik 2016-2017 ishte 118, ndërsa për vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 120 studentë të cilët do të ndjekin programin 1 vjeçar me 60 ECTS e sipas planit mësimor, programet e lëndëve, orari i mësimit.

8. Mësimdhënia

Procesi i mësimdhënjes organizohet duke kombinuar forma të ndryshme të leksioneve, seminareve, prazantimeve të detyrave të studenteve ushtrime praktike e profesionale dhe diskutimeve.

Studentët aktivizohen përgjatë gjithë semestrit në debate, në gjenerimin e ideve, në teste. Sa I takon vlerësimin përgjithësisht përqindjet variojnë sipas lëndëve dhe kritereve që përdoren. Gjithashtu studentët bëhen pjesë e projekteve të Fakultetit apo qendrave kërkimore të IAL-se MB. Duke respektuar interesat specifike dhe përvojat individuale të studentëve. Në varësi të specifikës së lëndëve të caktuara pedagogët operojnë dhe me teknologjitë e mësimdhënies. Pedagogët, tregojnë fleksibilitet për të ofruar mbështetjeje të tyre në varësi të kërkesave individuale që secili student kërkon.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies:

- Leksione - po
- Seminare - po
- Laboratore
- Praktikë lëndore - po
- Praktikë profesionale - po

Format e kontrollit të njohurive të larmishme, teste, bashkëbisedime, provim të ndërmjetëm, studime rasti, detyra kurse, esse, provim.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë

- Po. Një studente, përfituese e programit në fjalë, është anëtare e RVB.

9. Studentët

Në programin e studimit MP MEFS procedurat e pranimit të studentëve bëhen me procedurë vlerësimi të dosjes të kandidatëve. Modele të pranimit u vunë re të ishin pranime prej programeve bachelor të vetë UMB por edhe nga programe të institucioneve të tjera, të ngjashme dhe të njëjta. Nga këta studentë u tha se nuk kanë bërë vlerësim për kreditet e mbrojtura, apo provime shtesë. Studentët janë pranuar edhe me mesatare poshtë notës 6. Në dokumentacionin e propozimit për hapjen e programit, janë propozuar 25 kuota. Me Vendim Senati 9/16, dt. 02.11.2016 është marrë një vendim për pranimet në këtë program studimi në numrin 150 kuota, pas Raportit të Komisionit të MAS për verifikimin e kapaciteteve të infrastrukturës. Arsyeja pse u kërkua numër i vogël i studentëve në propozim, na u shpjegua se u bë për arsye të numrit të vogël të studenteve që vijonin studimet në ciklin e parë Bachelor të profilit Edukim Fizik në këtë institucion. Ky numër ishte rreth 40 studentë

Numri i studentëve të regjistruar për vitin akademik 2016-2017 ishte 118. Një nga këta studentë është larguar dhe aktualisht programin e studimit e kanë ndjekur 117 studentë nga të cilët njëri pa matrikull. Ndërsa për vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 120 studentë të cilët do të ndjekin programin 1 vjeçar me 60 ECTS.

Viti akademik thuhet se ka 30 javë por nga orari del se janë zhvilluar 37 javë mësimore. Studentët janë në dijeni për pengesën që kanë lidhur me kohëzgjatjen e Masterit dhe ndikimin e saj për hyrjen në provimin e shtetit pasi diploma e këtij programi ka vetëm 60 ECTS. Disa nga studentët punojnë aktualisht si Mësues të Edukimit Fizik. Ka edhe nga ata që kanë punuar edhe më përpara si Mësues të edukimit fizik. Për informimin lidhur me punësimin studentët nuk kanë dijeni se ka një zyrë kariere, por ky informacion u jepet nëpërmjet pedagogëve.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve bëhej me dosje individuale sipas kritereve të miratuara nga institucioni. Studentët në hyrje varionin me mesatare të ndryshme nga nota 6 deri në notën 8. Mesatarja në dalje akoma nuk është përpunuar pasi studentët nuk e kishin dhënë provimin përfundimtar. Studentë të regjistruar në

vitin e Parë (për herë të parë) janë 118 studentë për vitin akademik 2016-2017 dhe për vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 120 studentë

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve
 - egziston dokumentacioni i plotë për secilin student të regjistruar.
- Cilësia në hyrje e studentëve
 - në nivelin nën mesatare
- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë).
 - Nota Mesatare vaRion nga 6 në notën 8
- Studentë të diplomuar në vitin e fundit
 - ende nuk ka studentë të diplomuar, pasi provimi i formimit është planifikuar në nëntor.
- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend.
 - Studentët janë nga vetë institucioni apo nga institucione homologe, por ka edhe nga institucione të tjera jo të edukimit fizik dhe sporte.
- Të dhëna për punësimin e studentëve
 - ka disa studentë të punësuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p>	<p>Rezulton se: Pranimi dhe regjistrimi i studentëve këtë program është bërë conform ligjit dhe rregullores së institucionit, në kreun V, ku janë parashikuar rregullat për politikën e pranimit, kriteret, dokumentacionin e pranimit, procedurat e përzgjedhjes dhe procedurat e pranimit. Por në disa dosje studentësh kishte mungesa të dokumenteve si: diploma e bachelorit.</p>
<p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p>	<p>Rezulton se: Studentët e pranuar kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Studimeve.</p>
<p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p>	<p>Rezulton se: kërkesa për njohjen e certifikuar të gjuhës së huaj të mos jetë si kriter pranimi.;</p>
<p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve</p>	

“Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;

Kriteri 5

Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.

Rezultoni se: politikat e pranimit janë përshtatur me ndryshimet që i janë bërë legjislacionit të arsimit të lartë, kërkesave të tregut të punës dhe standardeve të cilësisë së institucionit.

Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.

Kriteri 1

Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;

Konfirmohet se: institucioni ka zyrë të informimit të studentëve që na u prezantua, por në takimin me student rezultoi se ku informacion realizohej vetëm nepërmjet komunikimit me E-mail.

Kriteri 2

Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;

Konfirmohet se: Njësia e studimeve Master i informon studentët për akreditimin e institucionit, të programeve të studimit, për procedurat e njohjes dhe vlefshmërisë së diplomave brenda dhe jashtë vendit, jep informacion për mundësitë për punësimin pas diplomimit.

Kriteri 3

Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.

Konfirmohet se: ka një Zyrë të Alumnit dhe Karrierës që ka për detyrë tu ofrojë studentëve informacion për punësimin pas diplomimit. Por rezultoi se ky kjo zyrë dhe ky informacion sic edhe del nga biseda me studentët nuk njihet. Nga ana tjetër përgjegjësjë e kësaj zyre ka një ngarkesë mësimore të plotë në auditor.

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Dëshmojmë që: institucioni dispononte statistika të sistemuara dhe dokumentuara për studentët që ishin të regjistruar në programin në fjalë. Kishte të dokumentuara gjithë frekuentimin e studentëve në lëndët e zhvilluara aktualisht dhe rezultatet e secilit. Për vitin akademik 2016-2017 u gjetën të regjistruar 118 studentë (1 student I larguar). Rezulton se dy student ishin pa numër matricullimi. Për vitin akademik 2017-2018 u gjetën të regjistruar 120 studentë.</p> <p>Konfirmohet se: Për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Mësues në Edukim Fizik dhe Sporte” janë në process diplomimi 117 studentë.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Rezulton se: institucioni ka një bazë të dhënash lidhur me studentët që diplomohen për programet e studimit që ofron, por në rastin e programit në fjalë nuk kemi të diplomuar ndaj nuk na është ofruar një informacion i tillë.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Rezulton se: Sekretaria mësimore dhe personeli akademik informon studentët për afatet e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit.</p> <p>Rezulton se: Sekretaria mësimore dhe personeli akademik informon studentët për rezultatet e vlerësimit gjatë programit.</p> <p>Rezulton se: Pedagogët komunikojnë me e-mail studentët për rezultatet akademike.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Rezultoni se: Institucioni ishte i mirëinformuar për ecurinë dhe vështirësitë e secilit student dhe ofronte mundësi kontaktesh individuale me secilin prej tyre jashtë programit të konfirmuar. Studentët i përmbushnin praktikën profesionale në institucionet respektive. Institucioni ndihmon studentët për procesin mësimor nëpërmjet këshillimit që ofrojnë pedagogët.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Konfirmojmë se pranimi dhe regjistrimi i studentëve në këtë program studimi është bërë konform ligjit dhe rregullores së institucionit. Pranohen studentë edhe nga programet Bachelor të tjera, pa kaluar në procedurën e vlerësimit të krediteve. Regjistrime për vitin akademik 2016-2017 u gjetën të regjistruar 118 studentë nga të cilët 1 është larguar, ndërsa për vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 120 studentë.</p> <p>Institucioni ishte i mirëinformuar për ecurinë dhe vështirësitë e secilit student. Studentët i përmbushnin praktikën profesionale në institucionet respektive. Nuk rezultojnë studente që janë tërhequr nga programi i studimit në fjalë. Janë të dokumentuara gjithë frekuentimi i studentëve në lëndët e zhvilluara deri aktualisht dhe rezultatet e secilit. Studentët nuk kishin mjaftueshëm informacion rreth mundësive të punësimit pas përfundimit të programit dhe diplomimit.</p> <p>Institucioni ka zyrë të informimit të studentëve. Komunikimi për rezultatet akademike Pedagog-student realizohet me e-mail, sekretaria mësimore dhe personeli akademik informon studentët për rezultatet e vlerësimit gjatë programit.</p> <p>Zyra e alumnit dhe karrierës funksionon por studentet nuk kanë mjaftueshëm informacion për këtë qëndër.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor Pjesa përshkrimore

Kërkimi shkencor në SHLUJ "Universiteti "Marin Barleti" është pjesë e rëndësishme e misionit dhe objektivave të tij dhe është në funksion të politikës tërësore të universitetit. Veprimtaria kërkimore-shkencore është përqendruar kryesisht në realizimin e kërkimit shkencor e të aplikuar, si dhe veprimtari të tjera sipas objektivave specifike të institucionit. Në këtë fakultet funksionon Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" (BIRD), Instituti Shqiptar për Çështje Publike (AIPA) dhe Instituti i Edukimit Barleti (IEB) të cilat bashkëpunojnë me institucionet e tjera kërkimore-shkencore si dhe agjencitë e zhvillimit në rajone më gjerë për organizime veprimtarive të përbashkëta dhe ofrojnë ekspertizë. Institucioni ka si objektiv që nëpërmjet stafit të brendshëm dhe atij të atashuar, të realizojë kërkime cilësore në fusha të veprimtarisë që mbulohen prej tyre, jo vetëm në bashkëpunim me njëri-tjetrin, por edhe me institucione të tjera kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit. Publikohet revista "Gjeopolitika" një herë në tre muaj duke u fokusuar në çështje tematike të rëndësishme bashkëkohore. Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit ka organizuar dy konferencave ndërkombëtare mbi familjen në vitin 2016, dhe ka organizuar në maj 2017 konferencën "Sporti ballkanik zhvillime dhe perspektiva" ku morën pjesë studjues të shquar të rajonit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor
Ka një përfshirje të stafit në punën shkencore dhe kualifikimin shkencor nepërmjet pjesmarrjes në aktivitete shkencore si konferenca, botime në revista shkencore dhe një përfshirje edhe e studentëve në këto veprimtari. Ka një strategji kërkimi shkencor që miratohet nga Senati që publikohet në faqen zyrtare të IAL-së, por që nuk pasqyrohet në dokumentacionin që ka Fakulteti apo departamenti.

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL (82 botime si IAL.)
- Numri i projekteve kërkimore të fituara (17 projekte si IAL.)
- Numri i projekteve të zbatuara (11 projekte të zbatuara si IAL.)
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL (3 konferenca shkencore si departament)
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL (nuk ka të dhëna si numër)
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor (nuk ka të dhëna si numër)
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor (ska të dhëna si numër)
- Numri i Çmimeve Kombëtare (nuk ka)
- Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Konfirmojmë se: personeli akademik ka publikime artikujsh shkencor apo pjesmarrje në konferenca të organizuara nga institucioni apo konferenca të organizuara brenda dhe jashtë vendit. IAL Marin Barleti publikon revistën periodike "Gjeopolitika", e cila përmban shkrime shkencore të pedagogëve të institucionit, por edhe të studiuesve jashtë etj.</p> <p>Konfirmojmë se: stafi akademik jep një kontribut konkret në zhvillimin e shkencës së edukimit nëpërmjet angazhimeve në veprimtarinë shkencore si dhe me botime.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Konfirmojmë se IAL Marin Barleti nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj në Programin Master Profesional Mësuesi në edukim fizik dhe sporte.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p>	<p>Rezulton: sipas raportit të vlerësimit të brëndëshëm, si dhe nga takimi i bërë me stafin akademik të departamentit se institucioni organizon programe të brëndëshme kualifikimi profesional me stafin e tij nga vetë pedagogë të stafit të tij dhe të tjerë të jashtëm me përvojë në mësimdhënie, por ne nuk na është prezantuar ndonjë evidencë lidhur me këtë veprimtari.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Rezulton se: Stafi akademik është përfshirë në projektshkencore si Erasmus + dhe institucioni mbështet financiarisht pjesmarrjen e pedagogëve në konferenca kombëtare apo ndërkombëtare.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p>	<p>Rezulton se institucioni disponon një raport individual të tërë pedagogëve për punën shkencore dhe botimet e cila është pasqyruar në anekset e raportit dhe është pjesë e procesit të vlerësimit të pedagogëve, por nuk rezulton se ka një bazë të dhënash lidhur me studimet shkencore të personelit.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p>	<p>Konfirmojmë se : institucioni ka projekte shkencor që janë pjesë e veprimtarisë të instituteve dhe qëndrave kërkimore të institucionit ku stafi akademik merr pjesë, dhe ndonjëse thuhet se janë të evidentuara nuk na vihet në dispozicion një praktikë e tillë.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Konfirmojmë se ka një përfshirje të stafit në punën shkencore dhe kualifikimin shkencor nepërmjet pjesmarrjes në aktivitete shkencore si konferenca, botime në revista shkencore dhe një përfshirje edhe e studentëve në këto veprimtari. Institucionika një strukturë efektive e cila përbëhet nga institute dhe qëndra kërkimore të cilat formulojnë dhe orientojnë politikën e zhvillimit të veprimtarisë kërkimore. Ka një revistë “ Gjeopolitika” ku behen publikimet e stafit të brëndshëm si dhe autorëve të tjerë brëndës dhe jashtë vendit.</p> <p>Rezulton se kjo veprimtari shkencore është programuar në strategjinë për kërkimin shkencor, dhe mbështetet edhe me planifikim në buxhetin e institucionit ka planifikim. Deklarohet se ka projekt kërkimor të përfshirë apo të zbatuar nga institucioni, por një informacion të tillë nuk na është ofruar.</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

IAL Marin Barleti”, ka një angazhim akademik të lidhur ngushtë me bashkëpunimin ndërkombëtar. Ndërkombëtarizimi i Universitetit dhe i Studentëve është edhe në funksion e akreditimit ndërkombëtar të Universitetit. Ndërkombëtarizimi konsiderohet si një nga aspektet të rëndësishme të strategjisë institucionale. Rezulton se ka marrëveshje dhe memorandum të nënshkruara me universitete brëndës dhe jashtë vendit, shkolla, institucione, struktura shtetërore të tjera në vend apo dhe pedagogë të huaj që kanë lidhje edhe me programet e studimit të ciklit të dytë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare (Ka një numër të konsiderueshëm pjesëmarrës në projekte shkencore por nuk na është ofruar me numër një informacion i tillë.)
 - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (Janë të afishuar në Eëb-in e institucionit 5 pedadogë të huaj por nuk ka informacion nëse kanë dhënë lëksion apo kanë marrë pjesë në veprimtarinë mësimore.) Ka edhe 6 pedadog të institucionit që janë ftuar nga institucione homologe jashtë vendit.
 - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit (Nuk e kemi nje informacion të tillë)
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL (16 studentë kanë shkuar jashtë në kuadrin e projektit Erasmus +)
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor (e përshtatshme)
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime (për numrin e madh të marrëveshjeve dhe projekteve që prezanton duhet të jetë më i madh në numër)

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
 - Institucionet qeveritare bashkëpunuese (bashkëpunim me 8 institucione qeveritare)
 - Organizatat Profesionale (bashkëpunim me 6 organizata profesionale)
 - Komuniteti i biznesit, tregu i punës (4 bashkëpunime me komunitete biznesi dhe tregu pune)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V.3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese; Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	Konfirmojmë se institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione qeveritar, organizata profesionale, komunitete biznesi dhe tregu pune si dhe OJF të cilat i mundësojnë studentët të realizojnë praktikën mësimore dhe të përfshihen në veprimtari kërkimore shkencore.
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Rezulton se ka një bashkëpunim mes departamenteve që konsiston në angazhimine reciproke të pedagogëve si specialistë të mirëfilltë në fushat përkatëse, duke garantuar përbushjen e objektivave të procesit mësimor në lëndë të ndryshme dhe duke rritur mundësitë e shkëmbimit të eksperiencave të pedagogëve.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Konfirmojmë se: Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p> <p>Rezulton se institucioni ka bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Arsimore në shumë rrethe të vendit si dhe me struktura të tjera shtetërore që mundësojnë kryerjen e praktikave profesionale dhe përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p> <p>Konfirmojmë se: institucioni ka organizuar trajnime profesionale me punëdhënësit, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka me to.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Konfirmojmë se IAL Marin Barleti ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit në shërbim të rritjes së cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të institucionit. Institucioni ka një politikë të efektshme të marrëdhënieve të bashkëpunimit me partnerë jashtë institucionit. Bashkëpunimi I institucionit me partnerë rezulton të jetë një pikë e fortë e tij në funksion të mësimit, kërkimit, praktikës dhe reputacionit.</p> <p>Rezulton gjithashtu se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me struktura shtetërore në Tiranë dhe në rrethe për zhvillimin e praktikave mësimore në shkolla qendra dhe organizata të ndryshme</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SËOT (STRENGTHS - PIKAT E FORTA, ËEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES - MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT)

a. Pika të forta:

- 1) Ndërtimi i institucionit dhe I programeve mbi bazën e një vizioni, misioni dhe plani të zhvillimit strategjik të qartë e të plotë. Plani strategjik i zhvillimit të institucionit është një dokument që orienton drejt dhe me realizëm zhvillimin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar në kontekstin e institucionit.
- 2) Politika e efektshme e marrëdhënieve të bashkëpunimit me partnerë jashtë institucionit, marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit në shërbim të rritjes së cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të institucionit.

- 3) Programi Master profesional Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte është ndërtuar që t'i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare. Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera nëpërmjet përmbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive.
- 4) IAL funksionon mirë nga pikëpamja e struktues dhe ka shumë njësi mbështetëse për procesin mësimor kërkimin shkencor veprimtari të ndryshme si institute dhe qendra, të cilat ndihmojnë në plotësimet e sđandarteve për pedagog dhe studentë.
- 5) Sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon mirë, dhe është në shërbim të rritjes së cilësisë të mësimdhënies.

b. Pika të dobëta

- 1) Programi i Studimit "Master profesional Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte" është hartuar në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Ligji nr.9741 "Për Arsimin e Lartë në Shqipëri, por hapja dhe zbatimi bëhet në kushtet e reja të krijuara pas daljes së Ligjit të ri Arsimin të Lartë. "Masteri profesional Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte" nuk është ristrukturuar për tu përgjigjur kërkesave të këtij ligjit të ri 80/2015 (neni 135 dhe 83) lidhur me përgatitjen e mësuesve të edukimit fizik për Arsimin e mesëm të ulët apo të lartë.
- 2) Literatura (libra broshura revista) pranë bibliotekës së këtij programi nuk është e pasur në numër po të marrim në konsideratë numrin e madh prej 117 studentë.
- 3) Cilësia e studentëve të regjistruar në program është e ulët. Nota mesatare hyrëse 6.3 dhe në dalje 6.7, niveli pothuajse i ulët i gjuhës së huaj, nuk përcjellin garancinë se disa prej tyre do të mund të plotësojnë misionin dhe objektivat e këtij programi, dhe nuk ofrojnë besimin se mund të kryejnë procese kërkimore.
- 4) Një raport jo i drejtë mes stafit akademik efektiv me atë me kontratë si në nivel Masteri ashtu edhe si departament që vë në dyshim mbulimin 70 % të ngarkesës nga pedagogë efektiv

c. Mundësitë:

- 1) Orientimi dhe strukturimi i këtij Programi Master profesional prej 60 ECTS drejt përgatitjes së specialistëve të mirëfilltë të edukimit fizik dhe veprimtarive sportive, i shmanget formimit profesional si mësues, duke e lënë këtë aspekt si objektiv e Masterit shkencor

d. Pengesat:

- 1) Institucioni ofron Master Shkencor Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sport me 120 ECTS, program që ka të njëjtin emërtim si edhe masteri profesional, në të cilin nuk ka studentë të regjistruar, Masteri shkencor me objektiva dhe synime të përafërta dhe mundësi punësimi të dyfishtë si specialist dhe mësues, gjë e cila vë në pikpyetje rregjistrimin e studentëve në këtë master profesional nëse ai bëhet 120 ECTS
- 2) Një numër i madh studentësh të regjistruar dhe veshitërisë të gjetjes se pedagogëve të kualifikuar në profilin e Edukimit fizik dhe sporte për mësimdhënie.

Në cilësinë e ekspertëve të jashtëm të grupit, theksojmë se Vendimi për të hapur "Master Profesional Mësuesi në Edukimin fizik dhe sport" dëshmon predispozitën e institucionit për tu angazhuar në studime të nivelit master.

Ky vullnet është tërësisht i përligjur, në kushtet kur, edukimi fizik dhe sportet kanë marrë një dimension të ri në politikën e qeverisë shqiptare ashtu edhe në shkollë dhe funksionon në rrethana të reja të shtimit të kërkesave për mësues dhe specialistë të përgatitur për këtë aspekt.

Por, referuar analizës, ballafaqimit me konstatimet që pamë gjatë vizitës në institucion, sygjerojmë: Së pari, kompletimin e diplomimit të studentëve aktualisht të regjistruar të cilët diplomohen në nëntor të këtij viti.

Për vitin 2017-2018 lipset një ri-formatim i programit bazuar në ligjin e ri të arsimit të lartë 80/2015 ose të rikonceptimit të tij si një master profesional 60 ECTS për formim dhe kualifikim vetëm të specialistëve të sportit dhe jo si mësues i edukimit fizik.

Sygjerojmë që të insistohet më shumë në cilësitë paraprake të formimit akademik të studentëve që do të regjistrohen në këtë program (p.sh. rritja e notës mesatare hyrëse që është 6.3), për të bërë të mundur përgatitjen kualitative të specialistëve të ardhshëm në këtë fushë

Rekomandojmë që akreditimi përfundimtar i programit në fjalë të bëhet me kushtet e lartpërmendur.

SUMMARY ANALYSIS OF EXTERNAL EVALUATION REPORT (EER) ACCORDING TO SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities and Threats) METHOD

a. Strong points:

- 1) Institution and this programs are compiled on basis of vision, mission and strategic development plan. The strategic development plan of the institution is a document that directly orientate and realistically toward national, regional and international development in the context of the institution.
- 2) Effective cooperation policy with third part partners, cooperation agreements with other homologous institutions within and abroad is to serve qualitative enhancement and internationalization of the institution.
- 3) This Professional Master Program "Teacher in Physical Education and Sports" is designed to serve the preservation of cultural values and national interests. This program treats supports and cultivates these values through teaching content, research and activities.
- 4) HEI work well from the point of view of the structure and there are many support units for the teaching process, research various activities such as institutes and centers, which supports in the supplementation for the lecturers and students
- 5) The internal control system works well, and it serves for enhancement of teaching quality

b. Weak Points

- 1) The Study Program "Professional Master The Physical and Sports Education Teacher" is designed in accordance with the criteria established by the Law No. 9741 "On Higher Education in Albania", but the opening and implementation takes place under the new conditions created after the exit of the New Law on Higher Education."Professional Master in Physical and Sports Education" has not been

restructured to respond to the requirements of this new Law 80/2015 (Articles 135 and 83) regarding the preparation of physical education teachers for lower or higher secondary education.

- 2) Literature (magazine, brochures, textbooks) at the library of this program is not rich in numbers if we take into consideration the large number of 117 students.
- 3) The quality of students enrolled in the program is low. The average entry level mark is 6.3 and outbound mark 6.7, the low level of foreign language, do not convey the guarantee that some of them will be able to fulfill the mission and objectives of this program and do not offer the confidence that they can carry out research processes.
- 4) An unjustified relationship between effective academic staff and contracted ones both at Master level and as a department that questions the 70% coverage of the workload by effective pedagogues

c. Options:

- 1) Orientation and structuring of this Professional Master Program of 60 ECTS towards the preparation of genuine specialists of physical education and sporting activities, avoids vocational training as a teacher, leaving this aspect as the objective of the Master of Science

d. Threats

- 1) There is a master's degree in Physical Education and Sport with 120 ECTS, which has the same degree as the master's degree, in which there are no registered students, a skincare master with approximate objectives and goals and double employment opportunities as a specialist and teacher, which questions the enrollment of students in this professional master if it becomes 120 ECTS
- 2) A large number of registered students and the difficulty of finding qualified pedagogues in the profile of Physical Education and Teaching Sport. As a group external expert, we note that the decision to open the "Master Professional Master in Physical Education and Sports" proves the institution's predisposition to engage in master level studies.

This willingness is fully justified in the conditions when physical education and sports have taken on a new dimension in both the Albanian government's and the school's policy and function in new circumstances of increasing the demand for teachers and specialists prepared in this regard.

But, referring to the analysis, dealing with the findings we saw during the site visit, we suggest: First, the graduation of the currently enrolled students who graduate in November this year.

For the year 2017-2018 a re-training program is required based on the new law on higher education 80/2015 or its reconsideration as a professional master's degree of 60 ECTS for training and qualification only of sports specialists and not as a teacher of education physical.

We suggest to insist more on the pre-academic qualifications of students enrolling in this program (eg increasing the average entry mark, which is 6.3), to enable the qualitative preparation of future specialists in this field

We recommend that the final accreditation of the program in question be made under the abovementioned conditions.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Gëzim Dibra
2. Prof. Asc. Dr. Ferdinand Canaj

